



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMI ORIENTUES
“VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR”
(VANAF)

VITI SHKOLLOR 2023 – 2024
KOORDINATORË: EDLIRA SINA DHE AURELA ZISI

PËRMBAJTJA

TABELA E PËRMBAJTJES.....	2
1 HYRJE.....	3
2 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT ORIENTUES	4
3 PËRSHKRIMI I KOMPETENCAVE QË VLERËSOHEN.....	4
4 STRUKTURA DHE PESHA E SECILËS LËNDË NË TEST	7
5 LLOJET E PYETJEVE/ KËRKESAVE/ USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA ...	8
6 SHKATHTËSITË DHE NJOHURITË SIPAS LËNDËVE	9
6.1 GJUHË SHQIPE.....	9
6.2 MATEMATIKË	15
6.3 DITURI NATYRE	21

1 HYRJE

Programi orientues për “Vlerësimin e Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor” –VANAF, është mbështetur në programet e lëndëve: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre, klasat 1-5.

Programi orientues ka si qëllim të orientojë punën e mësuesit, përgatitjen e nxënësve dhe hartuesit e testeve për VANAF. Programi përfshin konceptet, njohuritë, aftësitë dhe shprehjet më të rëndësishme që duhet të zotërojnë nxënësit në Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre në përfundim të arsimit fillor.

Vlerësimi i njohurive dhe i shkathtësive të *kompetencave gjuhësore* duhet të bazohet në parimin se të zotërosh njohuri dhe shkathtësi në lëndën e gjuhës shqipe *do të thotë të jesh në gjendje t’i demonstrosh* ato në tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare, si dhe në situata të jetës së përditshme.

Për vlerësimin e shkathtësive dhe të njohurive të *kompetencave matematikore* duhet të mbahet parasysh zbatimi i tyre nëpërmjet modelimeve, arsytimeve dhe zgjidhjes problemore në situata të thjeshta për nivelin bazë, si dhe modelimeve, arsytimeve, zgjidhjes problemore dhe interpretimeve në situata më komplekse për nivelet më të larta.

Vlerësimi i shkathtësive dhe i njohurive të *kompetencave shkencore* duhet të marrë në konsideratë aftësinë e nxënësve për të zbatuar njohuritë shkencore në jetën e përditshme dhe për t’i reflektuar në mënyrë kritike këto përvoja.

2 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT ORIENTUES

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, në program përshkruhen:

- kompetencat e lëndëve Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre;
- struktura dhe pesha e secilës lëndë në testim;
- llojet e pyetjeve/ ushtrimeve/ kërkesave që vlerësojnë në mënyrë efektive kompetencat e fushës që zotëron nxënësi;
- njohuritë dhe shkathtësitë kryesore për kompetencat të lëndëve Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre që do të vlerësohen.

3 PËRSHKRIMI I KOMPETENCAVE QË VLERËSOHEN

Kompetencat e lëndës së Gjuhës shqipe që vlerësohen në test janë:

Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• dallon temën, mesazhin dhe idetë kryesore në tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare;• analizon elemente të thjeshta në një tekst, si: përmbajtja, personazhet, mjedisi ose hapësira ku zhvillohen ngjarjet etj.;• dallon gjuhën e figurshme nga gjuha jo e figurshme.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• shkruan tekste të ndryshme duke u përqendruar në temën që do të trajtojë duke lidhur logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• dallon dhe përdor drejt lloje të ndryshme fjalish;• dallon dhe përdor drejt gjymtyrët kryesore të fjalisë;• dallon kategoritë gramatikore kryesore të emrit, foljes, mbiemrit, përemrit, si dhe gjen lidhëzat dhe parafjalët;• dallon fjalët e parme dhe jo të parme, si dhe pjesët përbërëse të fjalëve;• dallon dhe përdor sinonimet dhe antonimet.

Kompetencat e lëndës së Matematikës që vlerësohen në test janë:

Kompetenca: Lidhja konceptuale dhe të menduarit matematik	Kompetenca: Zgjidhja e situatës problemore	Kompetenca: Arsyetimi dhe vërtetimi matematik	Kompetenca: Modelimi matematik
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • rikujton faktet me saktësi; • përdor terminologjinë dhe përkufizimet matematikore; • përdor dhe interpreton saktë konceptet dhe simbolet matematikore; • kryen me saktësi procedurat standard. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcakton të dhënat e situatës problemore; • modelon një situatë problemore; • zbaton hapa të ndryshme për zgjidhjen e situatës problemore; • interpreton zgjidhjen e situatës problemore; • paraqet zgjidhjen e situatës problemore. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • identifikon elementet e situatës matematikore; • përdor konceptet matematikore dhe proceset e përshtatshme për situatën e dhënë; • arsyeton për zbatimin e koncepteve dhe proceseve në situatën e dhënë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kryen modelime në gjuhën matematike; • gjen zgjidhje matematike; • përkthen zgjidhjen matematike në zgjidhje të situatës në jetën reale.

Kompetencat e lëndës së Diturisë së natyrës që vlerësohen në test janë:

Kompetenca: Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre	Kompetenca: Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore	Kompetenca: Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • identifikon një problem ose përcakton një grup problemesh; • vlerëson qasjen e vet dhe të tjerëve. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor mjete, objekte dhe procedura të ndryshme shkencorenë përputhje me situatat dhe mënyrat e përdorimit të tyre në to; • vlerëson ndikimin e mjeteve, të instrumenteve dhe procedurave. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor efektivisht gjuhën e simboleve dhe të jetës së përditshme për të formuluar pyetje dhe për të argumentuar përgjigjet.

4 STRUKTURA DHE PESHA E SECILËS LËNDË NË TEST

Testi është i përbërë nga tri pjesë, të cilat përfshijnë lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre. Pesha e secilës lëndë në këtë provim është si në tabelën e mëposhtme.

Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre
45 %	35 %	20 %

Përmbushja e kompetencave lëndore nga ana e nxënësve arrihet nëpërmjet tematikave për secilën nga lëndët Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre.

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime e vlera. Për secilën tematikë/kompetencë është *paraqitur pesha që zë secila prej tyre kundrejt orëve totale* në zhvillimin e njohurive dhe rezultateve të të nxënësve që duhet të demonstrojë nxënësi në përmbushjen e kompetencave gjuhësore, matematikore dhe shkencore.

Tematikat/kompetencat dhe renditja e tyre nuk nënkupton që përmbajtja e testit duhet të zhvillohet në këtë renditje.

Tabela 1. Gjuhë shqipe

Kompetenca	Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Përdorimi i drejtë i gjuhës
Pesha	50 %	15 %	35 %

Tabela 2. Matematikë

Tematika	Numri	Matjet	Gjeometria	Algjebra dhe funksioni	Statistika dhe probabiliteti
Pesha	57%	19%	15%	2%	7%

Tabela 3. Dituri natyre

Tematika	Diversiteti	Ndërveprimet	Sistemet	Ciklet	Energjia
Pesha	12%	13%	38%	13%	24%

5 LLOJET E PYETJEVE/ KËRKESAVE/ USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA

Pyetjet që mund të përdoren në test janë:

- Pyetje me alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat).
- Pyetje me përgjigje: E vërtetë/ E rreme; Po/Jo; E saktë/ E gabuar.
- Pyetje me kombinime (me çiftim).
- Pyetje me përzgjedhje konceptesh apo simbolesh.
- Pyetje me plotësimin e vendeve bosh me informacionin e duhur nga një përkufizim apo proces.
- Pyetje me zëvendësim, zëvendësimi i një zgjidhje me të ngjashmen e saj.
- Pyetje për modelimin e situatave nga jeta reale në një situatë matematikore ose nga shkenca.
- Pyetje me përgjigje të shkurtër ose me plotësim.
- Pyetje subjektive me përgjigje të kufizuar.
- Pyetje subjektive me përgjigje të zgjeruar.
- Pyetje që vlerësojnë vlefshmërinë e zgjidhjes së një situatë problemore.

6 SHKATHTËSITË DHE NJOHURITË SIPAS LËNDËVE

Për secilën tematikë/kompetenca, më poshtë paraqiten njohuritë dhe shkathtësitë që duhet të demonstrojnë nxënësi për të përmbushur kompetencat e lëndës.

6.1 GJUHË SHQIPE

Njohuritë dhe shkathtësitë kryesore për kompetencat gjuhësore që do të vlerësohen.

Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Njohuritë	Shkathtësitë
<p>Tekste letrare: poezi, këngë popullore, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, romane për fëmijë.</p> <p>Nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">• Renditja e ngjarjeve në një tekst.• Tiparet kryesore të teksteve letrare.• Tema ose çështjet kryesore.• Analiza e thjeshtë e përmbajtjes, mjedisit dhe kohës në një tekst.• Analiza e thjeshtë personazhesh duke u bazuar në fjalët, tiparet e jashtme dhe veprimet e tyre.• Epiteti, krahasimi.• Rima dhe strofa në një poezi.	<p>Të lexuarit për të kuptuar tekstin</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• përdor disa strategji për të kuptuar tekstin (<i>para, gjatë dhe pas leximit</i>);• parashikon se çfarë do të ndodhë në tekst duke u bazuar në atë që ka lexuar më parë;• u përgjigjet pyetjeve rreth brendisë së tekstit;• tregon brendinë e pjesës që lexon;• përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me fragmente dhe detaje nga teksti;• lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën dhe leximet e mëparshme ose dukuri të jetës së përditshme;• krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje etj.;• dallon disa elemente të formës së teksteve dhe sqaron funksionin e tyre;• zbulon ngjashmëritë dhe ndryshimet mes teksteve të ndryshme që trajtojnë të njëjtën tematikë.

	<p>Të lexuarit e teksteve letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekste letrare, si: poezi, këngë popullore, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, romane për fëmijë; • u përgjigjet pyetjeve Kush? Çfarë? Kur? Ku? Pse? në lidhje me ngjarjet që ndodhin në tregim, përrallë, fabul, legjendë etj.; • dallon temat ose idetë kryesore në tekstet letrare; • tregon pjesën që i pëlqen më shumë dhe është më e këndshme për të, si dhe argumenton pëlqimin e tij/saj; • analizon brendinë dhe mjedisin ose hapësirën ku zhvillohen ngjarjet në një tekst; • analizon personazhet duke u mbështetur në fjalët, përshkrimet dhe veprimet e tyre; • gjen në një tekst rimën, krahasimin dhe epitetin.
<p>Tekste jo letrare: fletë ditari, udhëzime të shkurtra, sqarime, letra, njoftime, artikuj në revista për fëmijë etj. (të plota ose fragmente).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tema ose çështjet kryesore. • Tipare të thjeshta të një udhëzimi, një letre etj. 	<p>Të lexuarit e teksteve joletrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekste joletrare, si: udhëzime të shkurtra, sqarime, njoftime, letra, pjesë ditari, artikuj në revista për fëmijë etj.; • dallon temën ose idetë kryesore në tekstet joletrare; • analizon strukturën e një teksti të thjeshtë joletrar.

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Njohuritë	Shkathtësitë
<p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrime të shokëve, artistëve ose sportistëve të preferuar etj. • Rrëfime ngjarjesh rreth botës reale dhe imagjinare, si p.sh.: për pushimet, për librat, për universin, për lojërat etj. • Përshkrime të thjeshta personazhesh. 	<p>Të shkruarit si proces¹</p> <p>Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkruan duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe lidh logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre; • mbështet idetë me shembuj të ndryshëm; • shton, në një tekst, një dialog mes personazheve, një ndodhi të re, një paragraf etj.; • zbaton rregullat e drejtshkrimit gjatë të shkruarit; • rishikon tekstin që shkruan për të gjetur fjalët, shprehjet ose fjalitë e papërshtatshme dhe për t'i plotësuar ato me të tjera <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan natyrën, vendlindjen, fëmijërinë e tij/saj etj.; • përshkruan personazhet duke pasqyruar ndjenjat, mendimet dhe paraqitjen e jashtme të tyre; • rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth botës reale dhe asaj imagjinare; • shkruan një hyrje ose një mbyllje ndryshe të një

¹Këto aftësi dhe shkathtësi janë të përbashkëta për të gjitha llojet e teksteve që shkruajnë nxënësit.

	<p>tregimi, përralle etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> • krahason dy personazhe, ngjarje, mjedise nga një tregim, përrallë, fabul, roman për fëmijë etj., duke konkretizuar me shembuj dhe me ilustrime nga teksti; • shpreh me shkrim ndjenjat dhe përjetimet që i ngjall një poezi, një tregim etj.
<p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkrime njoftimesh të shkurtra. • Shkrimi i një letre drejtuar një miku ose një të afërmi. • Shkrimi i një flete ditari. • Shkrime ftesash për miqtë dhe shokët. 	<p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkruan letra, ftesa, ditar, njoftime etj.; • shkruan duke respektuar strukturën e tekstit që përfshin hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen; • respekton formën ose modelin e përshtatshëm, p.sh., gjatë shkrimit të një letre ose një njoftimi shkruan formulimet e hapjes e të mbylljes dhe nënshkrimin.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Njohuritë	Shkathësitë
<p>Njohuritë për klasën e pestë</p> <p>a) Sintaksë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fjalja si njësi leksiko-gramatikore, logjike dhe me intonacion të përfunduar. • Ndarja e fjalive sipas kumtimit. Veçoritë e tyre. • Grupi foljor dhe grupi emëror në fjali. • Gjymtyrët kryesore. Kallëzuesi. 	<p>a) Sintaksë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ndërton drejt fjali, duke pasur si bazë fjalën si njësi leksiko-gramatikore, logjikën e thënies, intonacionin e përfunduar; • heq, shton ose zhvendos fjalë në fjali, pa e prishur kuptimin e saj; • ndërton dhe dallon fjali dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse; • dallon rendin e fjalëve në fjalitë dëftore dhe

<p>Kryefjala, me çfarë është shprehur.</p>	<p>pyetëse;</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon grupin foljor dhe grupin emëror; dallon kryefjalën e shprehur me emër, përemër ose numëror; formon fjali ku kryefjala të jetë e shprehur me emër, përemër ose numëror.
<p>b) Morfologji</p> <p>Emri</p> <ul style="list-style-type: none"> Kategoritë gramatikore të emrit. <p>Mbiemri</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbiemri i nyjshëm dhe mbiemri e panyjshëm. Gjinia, numri dhe rasa e mbiemrit. Përshtatja e mbiemrit me emrin që shoqëron. <p>Përemri</p> <ul style="list-style-type: none"> Lakimi i përemrit vetor. Përemri pronor. Përemri pyetës (<i>Kush? Cili? Çfarë Ç'? Sa?</i>). <p>Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> Tri zgjedhimet e foljeve. Zgjedhimi në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme i foljeve <i>kam</i> dhe <i>jam</i>. Zgjedhimi në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme, 	<p>b) Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> krahason emrat e përgjithshëm me emrat e përveçëm; përcakton trajtën e emrit; lakon emrat sipas rasave; përcakton gjininë dhe numrin e emrit; përcakton trajtën, rasën, gjininë dhe numrin e mbiemrit; përshtat mbiemrin me emrin që shoqëron; dallon dhe lakon përemrin vetor; dallon përemrin pronor; dallon dhe përdor përemrat pyetës (<i>Kush? Cili? Çfarë? Ç'? Sa?</i>); përcakton zgjedhimin e foljeve; zgjedhon në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme foljet <i>kam</i> dhe <i>jam</i>; zgjedhon në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme, foljet e rregullta; dallon dhe përdor në fjali ndajfoljet.

<p>i foljeve të rregullta.</p> <p>Ndajfolja</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndajfolja, llojet. 	
<p>c) Fjalëformim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fjalët e parme dhe fjalët jo të parme. • Pjesët përbërëse të fjalës. 	<p>c) Fjalëformim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dallon fjalët e parme nga fjalët jo të parme; • dallon dhe analizon pjesët përbërëse të fjalës
<p>d) Drejtshkrim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i shenjave të pikësimit në fjalitë dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore. • Përdorimi i shkronjës së madhe tek emrat e përveçëm dhe në rastet e tjera, si: emërtimet e rrugëve, të institucioneve etj. 	<p>d) Drejtshkrim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor drejt shenjat e pikësimit në fjalitë dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore; • vendos saktë shenjat e pikësimit në dialog; • përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, tek emrat e përveçëm dhe në rastet e tjera.
<p>e) Leksikologji dhe semantikë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuptimet e fjalëve. • Sinonimet dhe antonimet. 	<p>e) Leksikologji dhe semantikë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcakton kuptimet e fjalës në kontekstin e dhënë; • krijon çifte sinonimie dhe antonimie; • dallon dhe përdor në fjali sinonimet dhe antonimet, për të përmirësuar gjuhën e folur dhe të shkruar.

6.2 MATEMATIKË

Njohuritë dhe aftësitë kryesore për kompetencat matematikore që do të vlerësohen.

TEMATIKA: Numri

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Shkathhtësitë për realizimin e kompetencave matematikore
<p>Numrat natyrorë, dhjetorë dhe të plotë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendvlera e secilës shifër në numrat pesë-gjashtëshifrorë. • Kuptimi i numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindta). • Rrumbullakimi i numrave katërshifrorë në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen më të afërt. • Rrumbullakimi i një numri dhjetor me dy shifra pas presjes në numrin e plotë më të afërt. • Krahasimi dhe renditja e numrave deri në një milion duke përdorur simbolet e krahasimit < dhe >. • Renditja dhe krahasimi i numrave pozitivë dhe negativë në një bosht numerik ose në shkallën e termometrit. • Renditja e numrave dhjetorë me një shifër ose dy shifra pas presjes. 	<p>Numrat natyrorë, dhjetorë dhe të plotë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton vlerën e secilës shifër në numrat pesë-gjashtëshifrorë dhe i ndan në mijëshe, qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe; • përdor kuptimin e numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindta) dhe gjen vlerën për secilën shifër; • rrumbullakos numrat katërshifrorë në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen më të afërt; • rrumbullakos një numër dhjetor me dy shifra pas presjes në numrin e plotë më të afërt; • krahason dhe rendit numrat deri në një milion duke përdorur simbolet e krahasimit < dhe >; • rendit dhe krahason numra pozitivë dhe negativë në një bosht numerik ose në shkallën e termometrit; • rendit numra dhjetorë me një shifër ose dy shifra pas presjes; • njeh shumëfisha të 5,10, 25, 50, 100 deri në 1000;
<p>Thyesat</p>	<p>Thyesat</p>

<ul style="list-style-type: none"> • Marrëdhënia ndërmjet $1/2$, $1/4$ dhe $1/8$; $1/3$ dhe $1/6$; $1/5$ dhe $1/10$; • Barazimi ndërmjet thyesave dhe numrave dhjetorë, p.sh., thyesa gjysma, të dhjetat dhe të qindtat. • Thyestat më të mëdha se 1 dhe numrat e përzierë. • Renditja e numrave të përzierë në një bosht numerik. • Pjesa e një sasive në situata të thjeshta. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • njeh marrëdhënien ndërmjet $1/2$, $1/4$ dhe $1/8$; $1/3$ dhe $1/6$; $1/5$ dhe $1/10$; • njeh barazimin ndërmjet thyesave dhe numrave dhjetorë, p.sh., thyesa gjysma, të dhjetat dhe të qindtat; • kthen një thyesë më të madhe se 1 në numër të përzierë, p.sh., $7/4$ në $1\frac{3}{4}$; • rendit numrat e përzierë në një bosht numerik; • njehson pjesën e një sasive në situata të thjeshta.
<p>Përqindja</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqindja si numri i pjesëve ndër 100 	<p>Përqindja</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton përqindjen si numri i pjesëve ndër 100 dhe njehson përqindje të thjeshta; • shpreh gjysmën, të dhjeta dhe të qindtat si përqindje.
<p>Raporti dhe përpjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Thyesa si raport ose përpjesëtim i thjeshtë 	<p>Raporti dhe përpjesëtimi</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor thyesën për të përshkruar një raport ose përpjesëtim të thjeshtë, p.sh., $1/5$ e rruazave janë të verdha.
<p>Mbledhja dhe zbritja</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbledhja e më shumë se tre numrave dy-treshifrorë. • Mbledhja ose zbritja e dy numrave tre-katërshifrorë. • Mbledh ose zbritja e dy numrave dhjetorë me të njëjtën numër 	<p>Mbledhja dhe zbritja</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mbledh më shumë se tre numra dy-treshifrorë; • mbledh ose zbret dy numra tre-katërshifrorë; • mbledh ose zbret dy numra dhjetorë me të njëjtën numër shifrash mbas presjes.

shifrash mbas presjes.	
<p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shumëzimi i numrave deri në 10000 me 10 ose 100. • Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifrorë. • Shumëzimi i dy numrave dyshifrorë. • Shumëzimi i një numër dhjetor me një shifër mbas presjes me një numër njëshifrorë. • Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifrorë (përfshirë edhe pjesëtimin me mbetje). • Shprehjet deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat. 	<p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shumëzon numrat deri në 10000 me 10 ose 100; • shumëzon dhe pjesëton numrat treshifrorë me numër njëshifrorë; • shumëzon dy numra dyshifrorë; • shumëzon një numër dhjetor me një shifër mbas presjes me një numër njëshifrorë, p.sh., $3,6 \times 7$; • pjesëton numrat treshifrorë me numër njëshifrorë (përfshirë edhe pjesëtimin me mbetje); • rrumbullakos rezultatin në një pjesëtim për të zgjidhur një situatë problemore; • njehson rezultatin e shprehjeve deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat; • zgjidh situata problemore duke përdorur veprimet dhe algoritmin e tyre.

TEMATIKA: Matjet

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave matematikore
<p>Gjatësia dhe masa</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësitë standarde: km, m, cm, mm, kg, g. • Numrat dhjetorë gjatë matjeve. • Këmbime me njësi të ndryshme. • Rrumbullakimi i matjeve në njësinë më të afërt. 	<p>Gjatësia dhe masa</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zgjedh dhe përdor njësitë standarde për gjatësinë dhe masën; • këmben njësi të kilometrit, metrit, centimetrit dhe milimetrit, kilogramit dhe gramit për të kryer matje në situata praktike.

	<ul style="list-style-type: none"> • rendit matje me njësi të përbëra; • rrumbullakos matjet në njësinë më të afërt; • zgjidh situata problemore nga jeta e përditshme ku përfshihen matjet.
Koha <ul style="list-style-type: none"> • Njësitë e kohës sekonda, minuta, ora, dita, muaji, viti. • Kalendari. 	Koha Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • përdor njësitë e kohës: sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti; • llogarit intervale të thjeshta në orë, minuta dhe sekonda; • përdor kalendarin dhe llogarit intervalet e kohës në muaj dhe vite, në ditë dhe javë nga situata të jetës reale.
Perimetri dhe syprina <ul style="list-style-type: none"> • Perimetri i shumëkëndëshit të rregullt dhe jo të rregullt. • Njësitë e sipërfaqes cm^2. • Formula për syprinën e drejtkëndëshit. 	Perimetri dhe syprina Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • mat dhe njehson perimetrin e shumëkëndëshit të rregullt dhe jo të rregullt; • kupton që syprina matet me katrorin e njësisë së gjatësisë, p.sh., cm^2; • përdor formulën për syprinën e drejtkëndëshit.
Vëllimi <ul style="list-style-type: none"> • - Litri, mililitri. 	Vëllimi Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • - njeh lidhjen ndërmjet litrit dhe mililitrit.

TEMATIKA: Gjeometria

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave matematikore
Gjeometria në plan <ul style="list-style-type: none">• Trekëndëshi dybrinjënjëshëm, barabrinjës dhe i çfarëdoshëm.• Drejtëzat paralele dhe pingule.• Këndet e drejtë, të ngushtë dhe të gjerë.	Gjeometria në plan <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• identifikon dhe përshkruan vetitë e trekëndëshave dhe i klasifikon dybrinjënjëshëm, barabrinjës dhe i çfarëdoshëm;• vizaton drejtëza paralele dhe pingule në figurat 2D;• kupton që këndi matet me gradë, mat këndet në 5^0 më të afërt;• identifikon, përshkruan dhe vlerëson masat e këndeve duke i klasifikuar ata në kënde të drejtë, të gjerë dhe të ngushtë;• mat kënde të vizatuara.
Gjeometria në hapësirë <ul style="list-style-type: none">• Kubi, kuboidi, cilindri, koni, sfera, prizmi, piramida	Gjeometria në hapësirë <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• dallon dhe emërton trupat 3D (kubi, kuboidi, koni, cilindri, sfera, prizmi dhe piramida);• klasifikon trupat 3D sipas numrit të brinjëve, faqeve, kulmeve.
Shndërrimet gjeometrike <ul style="list-style-type: none">• Simetria.• Drejtëza e simetrisë.• Rrjeti koordinativ.	Shndërrime gjeometrike <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• ndërton figura simetrike;• lexon dhe vendos koordinatat në kuadratin e parë të rrjetit koordinativ.

TEMATIKA: Algjebra dhe funksioni

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<ul style="list-style-type: none">Kutiza si vendmbajtëse numrash në barazime me mbledhje të dy numrave me katër –pesë shifra.Dallimi i ligjesisë dhe vazhdimi i një modeli konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">gjen numrin që duhet vendosur në kutizë në barazime me mbledhje ose me zbritje;përshkruan dhe vazhdon një model duke numëruar sipas një ligjësie.

TEMATIKA: Statistika dhe probabiliteti

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave matematikore
<p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none">Veçimi dhe klasifikimi i një grupi objektesh, sipas një ose dy cilësie të përbashkët.Diagramet në shtyllë dhe grafikët me vija.Moda.	<p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">i përgjigjet një pyetjeje nga jeta e përditshme duke grumbulluar, zbuluar ose klasifikuar të dhëna në një listë ose tabelë;përmbledh konkluzione në mënyrën e tij, duke identifikuar pyetje të tjera;përdor piktogramin, tabelën e dendurive, diagramin shtyllë për të prezantuar rezultatet;përdor intervalet me 2, 5, 10, 20 ose 100 njësi në diagramin shtyllë;gjen modën në një grup të dhënash.
<p>Probabiliteti</p> <ul style="list-style-type: none">Mundësitë që një ngjarje të ndodhë.	<p>Probabiliteti</p> <ul style="list-style-type: none">përshkruan mundësinë që një ngjarje familjare të ndodhë.

6.3 DITURI NATYRE

Njohuritë dhe shkathtësitë kryesore për kompetencat e fushës së shkencave natyrore që do të vlerësohen.

TEMATIKA: Diversiteti

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave të fushës së shkencave natyrore
<p>Njerëzit, kafshët dhe bimët</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngjashmëritë dhe ndryshimet midis njerëzve. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • identifikon pjesët kryesore të bimëve si: rrënja, kërcelli/trungu, gjethja, lulja, fruti, fara; • identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis njerëzve; • dallon dhe emërton pjesët kryesore të jashtme të trupit të njeriut.
<p>Materialet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Klasifikimi i materialeve. • Vetitë magnetike të materialeve. <p>Vetitë e materialeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Materialet natyrorë dhe materialet e prodhuar nga njeriu. <p>Gjendjet e lëndës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëndët dhe vetitë e tyre. • Përzierjet e lëndëve. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre; • përshkruan mënyrën se si disa materiale magnetizohen dhe disa jo; • identifikon dhe klasifikon materiale të përbëra nga lëndë natyrore dhe ato të prodhuara nga njeriu; • identifikon dhe përshkruan dallimet ndërmjet lëndëve të lëngëta, të ngurta dhe të gazta; • krahason trupa të ndryshëm sipas gjendjes së tyre; • përshkruan përzierjen e lëndëve të ndryshme dhe ndarjen e tyre.

TEMATIKA: Ndërveprimet

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave të fushës së shkencave natyrore
<p>Gjallesat në mjedisin e tyre</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mjediset lokale. • Përshtatjet në mjedis. • Ndikimi i mjedisit te bimët dhe kafshët. • Ndikimi i njeriut në mjedis. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjen mënyra me anë të të cilave mjediset lokale ndikojnë te bimët dhe kafshët që jetojnë aty; • jep shembuj për bimë dhe kafshë që jetojnë në habitate të ndryshme dhe diskuton për tipare me të cilat ata përshtaten me mjedisin ku jetojnë; • gjen mënyrat me të cilat veprimtaria e njeriut ndikon në habitate lokale dhe në kujdesin për mjedisin.
<p>Ndryshimet e materialeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tkurrja dhe bymimi i materialeve. • Tretja e materialeve në ujë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan mënyrën se si ndryshojnë materialet kur nxehen dhe kur ftohen; • identifikon materialet që treten në ujë dhe përshkruan aftësinë tretëse të tyre.
<p>Forcat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Forca e shtytjes dhe tërheqjes. • Efektet e forcës në lëvizjen e trupave. • Fërkimi. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan: <ul style="list-style-type: none"> ○ se forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre, ○ se forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin më shpejt, më ngadalë dhe t'u ndryshojnë atyre drejtimin e lëvizjes; • dallon ndikimin e ashpërsisë së sipërfaqes në lëvizjen e trupave mbi të.

TEMATIKA: Sistemet

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave të fushës së shkencave natyrore
<p>Njerëzit dhe kafshët</p> <ul style="list-style-type: none"> • Proceset jetësore. • E gjalla dhe jo e gjalla. • Klasifikimi i gjallesave. • Grupet kryesore të vertebrorëve. <p>Sistemet te bimët</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesat e një bime për të jetuar. • Transporti i ujit te bima. <p>Sistemet te kafshët</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ushqimet. • Shqisat te njeriu. • Mbështetja dhe lëvizja: kockat e skeletit dhe muskujt. <p>Ilaçet</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan proceset jetësore të përbashkëta te bimët dhe kafshët përfshirë të ushqyerit, lëvizjen, rritjen dhe riprodhimin; • përshkruan ndryshimet midis qenieve të gjalla dhe jo të gjalla duke përdorur njohuritë që kanë për proceset jetësore; • përshkruan si bimët dhe kafshët jetojnë (qëndrojnë gjallë); • ndan gjallesat në grupe duke përdorur dhe përshkruar tipare të thjeshta për t'i grupuar ato. • përshkruan: <ul style="list-style-type: none"> • si uji thithet nga rrënjët e bimës dhe transportohet përmes kërcellit; • se bimët kanë nevojë për rrënjë, kërcëj dhe gjethë që të rriten mire; • rritja e bimës ndikohet nga temperatura; • përshkruan se si përmes shqisave njerëzit dhe kafshët njohin botën rreth tyre; • përshkruan se si kockat e skeletit rriten, mbështesin dhe mbrojnë trupin; • emërton kockat kryesore në trupin e njeriut.
<p>Elektriciteti dhe magnetizmi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qarku elektrik. • Elementët përbërës të qarkut të thjeshtë elektrik. • Elektriciteti dhe përdorimet e tij. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • identifikon elementët përbërës të një qarku të thjeshtë elektrik (pilë/burim, fije përcjellëse, llamba elektrike) dhe rolin e secilit prej tyre; • shpjegon se llamba ndriçon ose jo, kur hapim

<ul style="list-style-type: none"> • Magnetet. • Polet magnetike të një magneti. • Vetitë magnetike të metaleve. <p>Toka dhe hapësira</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të saj. • Rrotullimi i Tokës rreth Diellit. • Sistemi diellor dhe yjet. 	<p>apo mbyllim çelësin;</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon se një pajisje elektrike nuk punon në qoftë se ka shkëputje në qark; • shpjegon se ndriçimi i llambave në qark zvogëlohet, kur shtojmë numrin e llambave në të dhe anasjelltas; • ndërton skemën e një qarku të thjeshtë elektrik në seri, me (pilë/burim, tela lidhës dhe llambë); • dallon përcjellësit nga jopërcjellësit; • përshkruan karakteristikat e magnetëve dhe përdorimin e tyre në jetën e përditshme; • përshkruan lëvizjen e Tokës dhe planetëve të tjerë në sistemin diellor; • përshkruan formimin e ditës dhe natës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj; • shpjegon formimin e stinëve si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth Diellit; • shpjegon se Dielli është një yll në qendër të sistemit diellor.
--	---

TEMATIKA: Ciklet

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave të fushës së shkencave natyrore
<p>Cikli jetësor te bimët, kafshët dhe njeriu</p> <ul style="list-style-type: none"> • Riprodhimi te bimët. • Rritja dhe ndryshimi te bimët. • Rritja dhe ndryshimi te kafshët përfshirë dhe njeriun. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan kushtet që ju duhen bimëve dhe kafshëve për të jetuar; • jep shembuj se si çdo organizëm i gjallë rritet dhe riprodhohet; • jep shembuj se si insektet pjalmojnë disa lule; • jep shembuj se si bimët me lule kanë një cikël jetësor që përfshin pllenimin, formimin e farës, shpërndarjen e farës dhe mbirjen; • tregon se njerëzit dhe kafshët lindin pasardhës që kur rriten ngjajnë me prindërit e tyre; • përshkruan ndryshimet që pësojnë gjatë ciklit të jetës kafshë si pula, bretkosa, flutura, kafshë shtëpiake dhe njeriu.
<p>Ndryshimet e gjendjes së lëndëve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimet e lëndëve gjatë ngrohjes dhe ftohjes. • Proceset e shkrirjes, ngrirjes. avullimit, kondensimit. • Qarkullimi i ujit në natyrë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan shndërrimin e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në to; • përshkruan procesin e shkrirjes dhe të ngurtësimit; • përshkruan proceset e vlimit, të avullimit dhe të kondensimit të ujit; • përshkruan dhe shpjegon qarkullimin e ujit në natyrë, duke dalluar faktorët që ndikojnë në të.

TEMATIKA: Energjia

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave të fushës së shkencave natyrore
<p>Tingulli</p> <ul style="list-style-type: none"> • Burimet e tingullit. • Përhapja e tingullit. • Karakteristikat e tingullit. <p>Drita</p> <ul style="list-style-type: none"> • Burimet e dritës. • Drita dhe errësira. • Hija dhe ndryshimet e saj. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan se tingulli: <ul style="list-style-type: none"> ○ përhapet nga një burim dhe në prani të një mjedisi lëndor; ○ përhapet përmes materialeve të ndryshme lëndore (trupa të ngurtë, lëngje dhe gaze); ○ dobësohet kur largohemi nga burimi që e prodhon atë; • jep shembuj të materialeve që nuk e lejojnë kalimin e tingullit përmes tyre; • jep shembuj të prodhimit të tingujve nga instrumentet frymorë; • identifikon burimet e ndryshme të dritës; • bën dallimin mes burimeve natyrore dhe artificiale të dritës; • shpjegon si përhapet drita në vijë të drejtë, por mund të ndryshojë drejtimin e saj; • përshkruan si formohet hija; • vrojton se hijet ndryshojnë pozicionin dhe madhësinë e tyre gjatë ditës; • shpjegon se: <ul style="list-style-type: none"> ○ trupat e patejdukshëm nuk e lejojnë dritën të depërtojë; ○ trupat gjysëm të tejudkshëm e lejojnë dritën të depërtojë pjesërisht; ○ trupat transparentë e lejojnë dritën të depërtojë plotësisht; • tregon se drita pasi pasqyrohet bie në syrin tonë dhe ne shohim trupat;

	<ul style="list-style-type: none">• shpjegon se sipërfaqet e ndritshme dhe të sheshta pasqyrojnë dritën;• shpjegon se sipërfaqet e ashpra e përthithin dritën;• tregon rrugën që përshkon rrezja rënëse nga burimi deri te syri ynë;• tregon si mbrohet syri nga drita e fortë e Diellit;• tregon se drita e bardhë përbëhet nga të gjitha ngjyrat e ylberit.
--	---